

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Shkurt, 2020
© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur për herë të parë publikimin me të dhëna për statistikat e investimeve të ndërmarrjeve në Kosovë, për vitin 2018.

Anketa e investimeve në ndërmarrje është realizuar në vitin 2019 për vitin referues 2018. Në kornizën e mostrës për këtë anketë janë të përfshira të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar blerje investive gjatë vitit 2018. Statistikat e investimeve në Kosovë do të jenë pjesë e programit të ASK-së. Ky format i publikimit do të ndryshoj në publikimin e radhës me rezultatet e vitit 2019. Në bazë të programit të punës statistikat e investimeve do të zgjerohen edhe me sektorët tjerë.

Komentët, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato mund të dërgohen në adresën elektronike: infoask@rks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga :

Ilir T. Berisha	-	Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike
Ismajl Sahiti	-	Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike
Ajshe Zuka-Ukaj	-	Zyrtare e Statistikave Ekonomike
Violeta Sylja	-	Zyrtare e Statistikave Ekonomike
Guxim Neziri	-	Zyrtar i TI-së për Statistika Ekonomike
Bekim Bojku	-	Zyrtar i Statistikave Ekonomike
Drita Sylejmani	-	Desiminim

Shkurt, 2020

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave dhe simboleve

: - Mungon dukuria

Përmbajtja

	Faqe
1 Metodologjia dhe përkufizimet-----	4
1.1. Metodologjia.....	4
1.2. Mbulimi.....	5
1.3. Përkufizimet.....	6
1.3.1. Investimet në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore) përfshijnë:.....	6
1.3.2. Investimet në makineri dhe pajisje.....	6
1.3.3. Investimet në produktet e pronësisë intelektuale dhe asetëve me vlerë.....	7
1.3.4. Investimet biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi përfshijnë.....	8
1.3.5. Investimet e tjera në asetet e prekshme (jo të prodhuara) përfshijnë.....	8
1.4. Popullacioni, mostra dhe shkalla e përgjigjeve.....	8
2 Rezultate e Anketës Statistikat e investimeve 2018-----	9
2.1. Investimet sipas aktivitetit ekonomik.....	10
2.2. Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve.....	11
2.3. Investimet sipas regjioneve.....	12
2.4. Blerjet e reja, të importuara dhe investime në vijim.....	13
2.5. Burimet e mjeteve për financimin e investimeve.....	14
3 Investimet sipas kategorive-----	15

1 Metodologjia dhe përkufizimet

1.1. Metodologjia

Anketa është kryer në territorin e Kosovës, në ndërmarrjet të cilat janë deklaruar se kanë pasur blerje investive gjatë vitit 2018. Për qëllime të kësaj ankete, "*Blerje investive*" nënkupton blerjen e mallrave kapitale: të prekshme (ndërtesa dhe struktura ndertimore, makineri dhe paisje, plantacione dhe serra bujqesore, kafshë, blerja e pronësisë mbi tokën etj.) dhe të paprekshme (licenca, patente, softuerë, etj.) të cilat kanë vlerë më të madhe se 1000 €, jetëgjatësi më tepër se një vit dhe përdoren për të krijuar pasuri apo gjeneruar të ardhura.

Korniza e mostrës përbëhet nga lista e ndërmarrjeve që kanë deklaruar blerje *investive* në deklaratat e TVSH-se për vitin 2018 në njëërën nga këto kategori:

- Blerjet dhe importet investive pa TVSH,
- Blerjet dhe importet investive me TVSH
- Importet investive vendore me normë 18%
- Importet investive vendore me normë 8%
- Blerjet investive vendore me normë 18%
- Blerjet investive vendore me normë 8%

Sipas këtyre deklarimeve, madhësia e kornizës së mostrës ka qenë 2,346 ndërmarrje. Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit "*Blerja investive vjetore në shumë mbi 20,000 euro*". Madhësia e mostrës sipas këtij kriteri ka qenë 1,257 ndërmarrje.

Të dhënat janë grumbulluar përmes pyetësorëve nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë në ndërmarrje. Nga totali prej 1,257 ndërmarrjeve të përzgjedhura për tu anketuar, anketës i janë përgjigjur 951 ndërmarrje, duke rezultuar me një shkallë të përgjigjes prej 75.66%.

Për analiza statistikore janë përdorur 951 ndërmarrje të cilat kanë rezultuar aktive dhe janë përgjigjur në anketë.

1.2. Mbulimi

Të dhënat me bazë vjetore që janë shfrytëzuar për publikim janë për vitin 2018. Në vrojtim u mbuluan ndërmarrjet e zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Biznësit të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NACE Rev.2 në nivel sektori:

	PËRSHKRIMI SEKTORËVE
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari
B	Xehetari dhe gurëthyes
C	Prodhim
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës
F	Ndërtimtari
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave
H	Transport dhe ruajtje
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim
J	Informacion dhe komunikim
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit
L	Aktivitete të patundshmërisë
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse
O	Administratë publike dhe mbrojtje
P	Arsim
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale
R	Art, zbavitje dhe rekreacion
S	Aktivitete të shërbimeve tjera

Investimet në anketë janë shpërndarë në pesë kategori:

1. Investimet në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore)
2. Investimet në makineri dhe pajisje
3. Investimet në produktet e pronësisë intelektuale dhe aseteve me vlerë
4. Investimet biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi
5. Investimet e tjera në asetet e prekshme(jo të prodhuara)

Po ashtu, investimet në kë anketë janë ndarë edhe sipas llojit të blerjeve:

1. Blerje investive të reja - të pa përdorura më parë (vendore)
2. Blerje investive të vjetra - të përdorura më parë (vendore)
3. Blerjet investive në vijim – që nuk janë në shfrytëzim deri më 31.12.2018 (vendore)
4. Blerjet investive të importuara

1.3. Përkufizimet

Blerjet investive të reja (të pa përdorura më parë) - nënkupton të gjitha investimet të cilat nuk kanë qenë në funksion (shfrytëzim) më parë nga ndërmarrjet tjera të Kosovës.

Blerjet investive të vjetra (të përdorura më parë) - nënkupton të gjitha investimet të cilat para blerjes kanë qenë në funksion (shfrytëzim) të ndonjë ndërmarrje tjetër në Kosovë. Këto blerje nuk konsiderohen si investime në nivel vendi.

Blerjet investive në vijim (nuk janë në shfrytëzim deri më 31.12.2018) - nënkupton investimet e papërfunduara të cilat nuk kanë qenë në funksion (shfrytëzim) nga ndërmarrja gjatë vitit.

Të importuara - nënkupton të gjitha investimet në makineri dhe pajisje, të cilat ndërmarrja i ka blerë jashtë vendit gjatë vitit 2018.

1.3.1. Investimet në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore) përfshijnë:

Ndërtesa dhe hapësira të banimit – përfshinë një ndërtesë banimi me një, dy, tre ose më shumë apartamente dhe shtëpi për banim.

Ndërtesa dhe hapësira jo-banimi - përfshinë hotelet dhe ndërtesat e ngjashme, ndërtesat e zyrave, ndërtesat për transport dhe komunikim, ndërtesat industriale dhe depo, spitale dhe ndërtesa shëndetsore, ndërtesat arsimore dhe edukative, ndërtesat për veprimtari kulturore, artistike dhe sportive.

Ndërtime metalike - përfshinë konstruksione të ndryshme nga metalet si; salla sportive, depo, shtylla elektrike, tezgja, tabela të reklamave dhe të tjera të ngjashme.

Infrastruktura e transportit - përfshinë autostradat, rrugët, hekurudhat, shtigjet e aeroportit, urat, tunelet, digat, brigje lumi dhe tjera të ngjashme.

Tubacionet, linjat e komunikimit dhe ato elektrike - përfshinë tubacionet për furnizim me ujë, tubacionet për kanalizim, linjat e telekomunikacionit dhe transmetimit elektrik.

Ndërtimet komplekse industriale - përfshinë termocentralet, ndërtesat për miniera dhe të tjera të ngjashme.

Përmirësimi i tokës - përfshinë mbrojtjen nga përmbytjet, kanalet, masat hidroteknike, bonifikimi i tokave dhe të tjera të ngjashme.

Ndërtesa tjera - të pa përmendura - përfshinë ndërtesat për sport dhe rekreacion, objektet ushtarake, deponitë dhe të tjera të ngjashme.

1.3.2. Investimet në makineri dhe pajisje

Automjetet e udhëtarëve (pasagjerëve) – përfshinë auto veturat, furgonët, autobusët, motoçikletat dhe tjera të ngjashme për transportin e udhëtarëve.

Automjetet e mallrave – përfshinë kamionë transportues të mallrave (deri në 5 ton; nga 5 ton deri 20 ton dhe mbi 20 ton) dhe rimorkio.

Automjete dhe pajisje të tjera – përfshinë të gjitha mjetet e transportit me motor për qëllime të veçanta (p.sh. kamionët për autobartje, kamionët vinç, mjetet e transportit për shuarjen e zjarrit, auto betonierët, mjetet për pompimin e betonit, makinat për pastrimin e borës nga rruga, makinat për larje të rrugës, ofiçinat e lëvizshme, njësitë radiologjike të lëvizshme).

Produkte metalike - përfshinë strukturat metalike, tankerët (cisterna), rezervuarët, kontejnerët, kaldajat dhe pajisjet e ngrohjes qendrore dhe tjera të ngjashme.

Makineritë e tjera për qëllime të përgjithshme – përfshinë makinat për prodhimin dhe shfrytëzimin e energjisë mekanike (motorë, turbina, pompa, kompresorë), vegla makinerish (për ngritje, transport, ftohje, ventilim), peshore dhe tjera të ngjashme.

Makineritë e tjera për qëllime të veçanta – përfshinë makineritë metalurgjike, makineritë për miniera dhe ndërtime, makineritë për industri përpunuese (mulli gruri, ushqimore, tekstilit, përpunim të metaleve, drurit, gurit etj.) dhe tjera të ngjashme.

Makina dhe pajisje të tjera elektrike – përfshinë motorë elektrik, gjeneratorë, transformatorë, pajisje shpërndarëse për energji elektrike, sistemet e ndriçimit në rrugë dhe në natyrë, gjeneratorë me avull dhe tjera të ngjashme.

Makineri bujqësore – përfshinë traktorë, kombajna dhe makineri tjera bujqësore dhe pyjore.

Kompjuterë dhe pajisje kompjuterike-periferike – përfshinë kompjuterë, laptopë, printerë, skanerë, fotokopjues, tabletë dhe tjera të ngjashme.

Pajisje të komunikimit dhe aparatet elektronike – përfshinë pajisjet dhe aparatet e radios, televizionit dhe komunikimit, (radio transmetues, telefon, faks) dhe tjera të ngjashme.

Pajisje dhe instrumente mjekësore – përfshinë pajisje dhe instrumente për qëllime mjekësore (ultrazë, CT, rezonanca magnetike, rentgen, laparoskop, aparate laboratorike, mikroskop, otoskop), instrumente të përdorura në stomatologji, pajisje optike dhe tjera të ngjashme.

Pajisje dhe instrumente tjera – përfshinë pajisje dhe instrumente muzikore, sportive, për lojëra të ndryshme dhe tjera të ngjashme.

1.3.3. Investimet në produktet e pronësisë intelektuale dhe aseteve me vlerë

Blerjet e patentave, licencave dhe të drejtave të autorit - përfshinë blerjet e bëra në patenta, licenca dhe të drejta të autorit për qëllime të prodhimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.

Hulumtimi dhe zhvillimi për nevojat e ndërmarrjes – përfshinë shpenzimet e bëra në kërkim dhe zhvillim të kryera nga vet ndërmarrja për nevoja të saj.

Eksplorime gjeologjike (Eksplorimi i minierave dhe mineraleve) – përfshinë shpenzimet e bëra për hulumtimet gjeologjike (xeheve, gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gipsit, shkumësit dhe rrasave, mineraleve kimike etj.).

Softueri i blerë (licencat e softuerit) - nënkupton një licencë softuerësh i cili është një dokument që siguron udhëzime ligjërish të detyrueshme për përdorimin dhe shpërndarjen e softuerit.

Softuerë të zhvilluar për nevoja të biznesit – nënkupton softuer që janë përvetësuar ose zhvilluar për të përmbushur nevojat e brendshme të një biznesi.

Bazat e të dhënave të blera - nënkupton blerjen e bazave të të dhënave të gatshme.

Bazat e të dhënave të prodhuara - nënkupton krijimin e bazës së të dhënave të cilat krijohen nga vetë biznesi vetëm për nevoja vatanake të atij biznesi.

Krijime origjinale artistike dhe letrare - përfshinë filma, radio dhe programe televizive, vepra muzikore dhe të tjera.

Koncesionet, licencat, lejet e tjera të punës dhe të drejtat e ngjashme që nuk janë përmendur më lart – përfshinë një vepër ose shpikje që është rezultat i krijimtarisë, siç është një dorëshkrim ose një model, për të cilin dikush ka të drejta dhe për të cilin mund të kërkojë një patentë, të drejtën e autorit, markën tregtare, etj.

1.3.4. Investimet biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi përfshijnë

Kopetë primare (shtazore) që japin produkte të përsëritura - përfshinë blerjen e kafshëve (Lopë, dele, dhi, buallica, kuaj dhe tjera të ngjashme) për qëllime të mbarështimit dhe prodhimin e produkteve të përsëritura (qumështit, leshit etj.) duke përjashtuar kafshët për therje.

Plantacionet afatgjata (më shumë se një vit) – përfshinë shpenzimet e bëra për mbjelljen e sipërfaqes tokësore apo sipërfaqet e mbjellura me molla, arra, rrush, kumbulla, dardha, pjeshka, mjedra, qershia dhe tjera të ngjashme për qëllime të prodhimit të frutave që kanë jetëgjatësi dy e më shumë vite.

Serrat – përfshinë shpenzimet e bëra për ndërtimin ose blerjen e serrave (si konstruksion) për kultivimin e produkteve të ndryshme bujqësore.

1.3.5. Investimet e tjera në asetet e prekshme (jo të prodhuara) përfshijnë

Blerja e tokës – përfshinë blerjen e tokës, depozitave nëntokësore, pyjeve dhe ujërave.

Shpenzimet e transferimit të pronësisë mbi tokën – përfshinë koston e transferimit të pronësisë mbi tokën të bëra nga blerësi duke përfshirë shpenzimet noteriale (blerja e tokës nuk përfshihet).

Blerja e produkteve të çmuara – përfshinë blerjen e produkteve të çmuara (gurë të çmuar dhe metale të tilla si diamante, ari jo monetar, platini, dhe mjete argjendi), vepra artistike të vjetra (piktura, skulptura dhe tjera të ngjashme).

1.4. Popullacioni, mostra dhe shkalla e përgjigjeve

Popullacioni i ndërmarrjeve, prej të cilit ëshë bërë përzgjedhja e mostrës për anketim, numëron 2,346 ndërmarrje, të marrura nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB). Numri i ndërmarrjeve të zgjedhura për mostër është 1,257 ndërkaq, prej tyre 951, përkatësisht 75.66% i janë përgjigjur anketës.

Shkalla e përgjigjeve për statistikat e investimeve		2018
1	Numri i ndërmarrjeve në popullacion	2346
2	Numri i ndërmarrjeve të zgjedhura në mostër	1257
3	Numri i pyetësorëve të shpërndarë në ndërmarrje	1080
4	Numri i pyetësorëve të përdorur në analizim të të dhënave	951
5	Numri i rasteve të klasifikuara si të pa përgjigjur, këtu përfshihen refuzimet, rastet kur nuk ka pasur përgjigje ose ndonjë komunikim	96
6	Të pagjetura	25
7	Ndërmarrjet Pasive/Shuara	8
8	Të pakontaktuara	177
Shkalla e përgjigjeve në %		75,66%

2 Rezultate e Anketës Statistikat e investimeve 2018

Sipas rezultateve në nivel ankete vlera e investimeve në total në vitin 2018 është 248.772.419 €. Blerjet e vjetra nuk janë konsideruar si investime në nivel vendi sepse kanë qenë në funksion (shfrytëzim) të ndonjë ndërmarrje tjetër në Kosovë. Investimet në ndërtim zënë peshën kryesore, me 68.73% të investimeve në kuadrin e investimeve totale të ndërmarrjeve të përfshira në anketë. Investimet tjera që zënë një peshë të konsiderueshme janë ato në makineri dhe pajisje me 21.32%, ndërsa investimet në produktet e pronësisë intelektuale, investimet biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi, si dhe investimet në asete të prekshme sillen nga 1% deri në 5% (shih Grafikoni1).


Tabela 1: Vlera e investimeve sipas kategorive

në Euro

Investimet sipas kategorive	Blerjet e reja	Blerjet e vjetra	Të importuara	Investime në vijim	Gjithsej
	a	b	c	d	e=a-b+c+d
Investime në Ndërtim	139.249.936	31.624.328	:	31.724.375	170.974.311
Investime në makineri dhe pajisje	36.808.318	17.675.419	16.239.343	:	53.047.661
Investime në produktet e pronësisë intelektuale	3.908.263	:	5.968.644	12.700	9.889.607
Investime biologjike në bujqësi	1.859.199	125.000	0	:	1.859.199
Investime në asete të prekshme	12.568.404	534.300	4.204	429.033	13.001.641
Gjithsej investime 2018	194.394.120	49.959.047	22.212.191	32.166.108	248.772.419

Grafikoni 1: Investimet sipas kategorive

në %



2.1. Investimet sipas aktivitetit ekonomik

Nëse shikojmë investimet sipas aktivitetit ekonomik, aktivitetet me më së shumti investime janë: ndërtimtaria me 44.55%; tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike, motoçikletave me 22.27% dhe prodhimi me 9.83%.


Tabela 2: Investimet sipas aktivitetit ekonomik

në %

Sektoret	Investime në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore)	Investime në makineri dhe pajisje	Investime në produktet e pronësisë intelektuale dhe asetete me vlerë	Investime biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi	Investime në asetete të prekshme (jo të prodhuara)	Gjithsej Investime 2018
A	0,42	0,51	0,00	6,10	0,50	0,47
B	0,30	0,25	0,00	0,00	0,00	0,26
C	6,37	21,52	17,51	18,74	8,01	9,83
D	3,15	0,07	0,00	0,00	0,00	2,25
E	6,49	6,59	0,11	0,00	1,88	5,95
F	54,77	11,33	3,87	3,77	61,46	44,55
G	15,70	34,84	71,26	60,48	22,49	22,27
H	0,41	4,27	0,43	0,00	0,00	1,11
I	4,20	3,30	1,36	9,57	0,29	3,75
J	0,79	4,05	0,55	0,00	0,14	1,35
K	0,00	0,59	3,80	0,00	0,00	0,27
L	1,22	4,05	0,00	0,00	3,85	1,83
M	1,39	2,80	0,50	1,34	0,00	1,54
N	1,34	1,72	0,35	0,00	1,38	1,36
O	0,00	0,09	0,00	0,00	0,00	0,02
P	0,24	0,45	0,12	0,00	0,00	0,26
Q	3,18	2,36	0,13	0,00	0,00	2,71
R	0,03	0,35	0,01	0,00	0,00	0,09
S	0,00	0,87	0,00	0,00	0,00	0,16
Gjithsej	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00

Grafikoni 2: Investimet sipas aktivitetit ekonomik

në %



2.2. Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve

Siç edhe mund të shihet në grafikonin 3, mbi 72 % e investimeve të ndërmarrjeve të përfshira në anketë janë realizuar nga ndërmarrjet mikro (1-9 punëtor) dhe ato të vogla (10-49 punëtorë). Ndërsa ndërmarrjet e mesme (50-249 punëtor) dhe ato të mëdha (250 +), marrin pjesë me rreth 28% investimeve totale.


Tabela 3: Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve

në %

Madhësia e Ndërmarrjeve sipas numrit të punësuarve	Investime në Ndërtim	Investime në makineri dhe pajisje	Investime në produktet e pronësisë intelektuale	Investime biologjike në bujqësi	Investime në asete të prekshme	Gjithsej investime 2018
1-9	38,30	39,13	23,26	31,69	18,56	36,72
10-49	34,33	35,52	65,46	68,31	26,93	35,70
50-249	20,43	18,02	2,01	0,00	53,60	20,86
250+	6,93	7,33	9,27	0,00	0,92	6,72
Gjithsej	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00

Grafikoni 3: Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve

në %



2.3. Investimet sipas regjioneve

Sipas rezultateve në nivel të anketës, ndërmarrjet të cilat janë të koncentruara në Regjionin e Prishtinës, kanë realizuar përqindjen më të lartë të investimeve 44.38 % gjatë vitit 2018. Pas regjionit të Prishtinës, pason regjioni i Ferizajit me 16.52%, Peja me 13.97%, Prizreni me 12.59% e kështu me radhë (Tabela 4).


Tabela 4: Investimet sipas regjioneve dhe sektorit të investimit

në %

Regjionet	Investime në Ndërtim	Investime në makineri dhe pajisje	Investime në produktet e pronësisë intelektuale	Investime biologjike në bujqësi	Investime në asete të prekshme	Gjithsej investime 2018
Gjakovë	3,45	2,01	2,19	1,61	0,00	2,93
Gjilan	9,53	8,88	0,15	0,00	6,95	8,81
Mitrovicë	0,18	2,19	0,01	0,00	4,54	0,78
Pejë	15,46	9,93	0,27	13,64	18,85	13,97
Prizren	8,79	18,68	22,47	0,19	35,88	12,59
Prishtinë	41,73	50,40	72,43	84,56	31,47	44,38
Ferizaj	20,86	7,92	2,47	0,00	2,31	16,52
Gjithsej	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00

Grafikoni 4: Investimet sipas regjioneve dhe kategorisë së investimeve

në %



2.4. Blerjet e reja, të importuara dhe investime në vijim


Tabela 5: Blerjet e reja, të importuara, investime në vijim

në %

Sektoret	Blerjet e reja	Të importuara	Investime në vijim	Gjithsej Investime 2018
A	1,89	0,00	0,01	1,53
B	0,55	0,59	0,00	0,48
C	19,26	18,72	16,05	18,80
D	0,02	0,00	0,00	0,01
E	7,28	0,00	0,28	5,92
F	34,11	9,90	63,44	36,62
G	21,55	57,59	10,24	22,14
H	2,06	5,25	0,00	1,97
I	4,29	0,38	0,41	3,54
J	1,03	0,82	0,00	0,88
K	0,09	1,99	0,00	0,19
L	2,27	0,00	0,00	1,83
M	1,83	0,68	0,00	1,51
N	1,58	1,42	0,00	1,36
O	0,02	0,00	0,00	0,02
P	0,25	0,79	0,00	0,25
Q	1,72	0,37	9,59	2,69
R	0,10	1,50	0,00	0,17
S	0,10	0,00	0,00	0,08
Gjithsej	100,00	100,00	100,00	100,00

Grafikoni 5: Blerjet e reja, të importuara, investime në vijim

në %



2.5. Burimet e mjeteve për financimin e investimeve

Sa i përket burimit të investimeve, siç mund të shihet në tabelë 51.54% e vlerës së investimeve të ndërmarrjeve është realizuar nga fondet e veta, 21.62% nga bankat vendore dhe 19.15 % nga bashkë-investitorët vendor.


Tabela 6: Burimet e investimeve

në %

Burimet e investimeve	Investimet 2018
Nga fondet e veta	51,54
Me bashkë-investitorët vendas	19,15
Me bashkë-investitorë të huaj	3,18
Nga bankat vendore	21,62
Nga kreditorët e huaj	0,01
Përmes leasing-ut financiar gjatë vitit 2018	0,33
Nëpërmjet një ujdje (kompensimi) në vitin 2018	0,31
Huazim ose borxh si (llogari të pagueshme)	0,14
Nga fondet e qeverisë qendrore dhe lokale	0,41
Tjetër	3,30
Gjithsej	100,00

Grafikoni 6: Burimet e investimeve

në %



3 Investimet sipas kategorive

Tabela 7: Investimet në ndërtim (ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore)

në %

Përshkrimi	Gjithsej
Vlera e investimeve ndërtimore	100,00
Punët ndërtimore	81,46
Ndërtesa dhe hapësira të banimit	42,46
Ndërtesa dhe hapësira jo-banimit	33,05
Ndërtime metalike	5,94
Struktura tjera ndërtimore	18,54
Infrastruktura e transportit	6,01
Tubacionet, linjat e komunikimit dhe ato elektrike	8,56
Ndërtimet komplekse industriale	3,01
Përmirësimi i tokës	0,07
Ndërtesa tjera - të pa përmendura	0,89

Tabela 8: Investimet në makineri dhe pajisje

në %

Përshkrimi	Gjithsej
Makineri dhe pajisje	100,00
Pajisjet e transportit	38,71
Automjetet e udhëtareve (pasagjerëve)	13,82
Automjetet e mallrave	7,94
Automjete dhe pajisje të tjera	16,95
Makineri dhe pajisje të tjera	61,29
Produkte metalike	3,12
Makineritë e tjera për qëllime të përgjithshme	8,30
Makineritë e tjera për qëllime të veçanta	28,26
Makina dhe pajisje të tjera elektrike	3,77
Makineri bujqësore	2,01
Kompjuterë dhe pajisje kompjuterike-periferike	9,15
Pajisje të komunikimit dhe aparatet elektronike	0,75
Pajisje dhe instrumente mjekësore	1,61
Pajisje dhe instrumente tjera	4,32

Tabela 91: Investimet në produktet e pronësisë intelektuale dhe asetëve me vlerë

në %

Përshkrimi	Gjithsej
Vlera e investimeve në vitin 2018	100,00
Produktet e pronësisë intelektuale	24,93
Blerjet e patentave, licencave dhe te drejtave te autorit	11,26
Hulumtimi dhe zhvillimi për nevojat e ndërmarrjes	10,63
Eksplorime gjeologjike (Eksplorimi i minierave dhe mineraleve)	3,03
Softueri kompjuterik dhe bazat e të dhënave	75,07
Softueri i blerë (licencat e softuerit)	1,91
Softuerë të zhvilluar për nevoja të biznesit	5,76
Bazat e të dhënave të blera	1,63
Bazat e të dhënave të prodhuara	0,70
Krijime tjera origjinale artistike dhe letrare	0,17
Koncesionet, licencat, lejet e tjera të punës dhe të drejtat e ngjashme që nuk janë përmendur më lart	0,17
Produkte tjera te pronesise intelektuale që nuk janë përmendur më lart	64,72

Tabela 20: Investimet biologjike te kultivuara dhe serrat ne bujqësi

në %

Përshkrimi	Gjithsej
Pasuri biologjike të kultivuara dhe serrat ne bujqësi	100,00
Pasuri biologjike të kultivuara	94,41
Kopetë primare (shtazore) që japin produkte të përsëritura	68,71
Plantacionet afatgjata (më shumë se një vit)	25,70
Serrat	5,59

Tabela 11: Investimet e tjera ne asetete te prekshme (jo të prodhuara)

në %

Përshkrimi	Gjithsej
Vlera e investimeve në asetete e prekshme jo të prodhuara për vitin 2018	100,00
Blerja e tokës	99,31
Shpenzimet e transferimit të pronësisë mbi tokën	0,49
Blerja e produkteve të çmuara	0,20

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

330.332(496.51)”2018”

Statistikat e investimeve në ndërmarrje 2018 / ky publikim është
përgatitur nga Ilir T. Berisha... [et al.]. -Prishtinë : Agjencia e
Statistikave të Kosovës, 2020. – 21 f. : ilustr. ; 28 cm. - (Seria 3 :
Statistikat Ekonomike)

1.Berisha, Ilir T.

ISBN 978-9951-22-636-3

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 159 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-636-3



9 789951 226363